



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 24 prot.

Kamëz, më 18.2 .2022

V E N D I M

Nr. 21 Datë 18/2 2022

MBI

“ MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR ATO INDIVID/FAMILJE QË NUK PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË PËR VITIN 2022 “ DHE MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT PËR KËTË PROGRAM “

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 18.2.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.19 Datë 15.2.2022 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 dt.20.05.2019 " Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qiras për kategoritë që gëzojnë për parësinë subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe menyrën e llogaritjes së tij " VKM nr.459 dt.03.07.2019 "Rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehim" Udhëzim nr.31 dt.18.11.2019 " Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret përpërfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit" Vendimit nr.65 datë 25.06.2020, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”, Vendimit nr.4 datë 17.01.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë për Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë ”, Vendimit nr 132 dt.22.12.2021 për “ Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2022, ”Proces-Verbal i komisionit të strehimit nr.1191 prot. dt.09.02.2022 " Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2022 ", shkresës me nr.prot.1237 dt.24.01.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe bazuar në vendimin e marrë nga Komisioni i Strehimit, si dhe relacionit të hartuar nga grupi i punës, , **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

V E N D O S I:

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/ familjet, sipas listës bashkëlidhur si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Sistemin e pikëzimit për programin e “Subvencionimit të qirasë në tregun e lirë”, për familjet që nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2022. Bashkëlidhur tabela nr.1, dhe lista e dokumentave si pjesë e këtij vendimi.
3. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë 1 (një vjeçare), duke filluar nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022.
4. Efektet financiare që rrjedhin nga pika “1”, në shumën prej **20,327,400 (njëzet milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind) lekë për 12 muaj, do të përballohen me bashkëfinancim (80%-20%) në masën prej 16,261,920 (gjashtëmbëdhjet milion e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëqind e njëzet) lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe me vlerë 4,065,480 (katërmilion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë nga buxheti i Bashkisë Kamëz sipas Prog 06180 Art 606.**
5. Ngarkohet Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë.**

Kryetar Këshilli

Hysen Koldashi

